REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 25 – 5674 – 2-1-1/C1120
14 Nr. 1161/25
Dt. 13.10.2025

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Publike Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. **Komuna e Vushtrrisë**, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë PORORSITËSI) , dhe

2. **" Menagement and Information Technology Consulting M&IT L.L.C. ",** emri i biznesit/ " Menagement and Information Technology Consulting M&IT "emri tregtar, me seli në Ferizaj, me **ARBK: 811558941**, të cilën e përfaqëson **znj. Arena Sylejmani** , në tekstin e mëtejmë KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMIT, janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon: **Inspektimi i objekteve për qëllim të tatimit në pronë dhe shërbimeve për inkasimin e obligimeve të tatimit në pronë**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	56	7	4	2	1	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	3	7	2	1	1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose furnizimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : Shërbime të nevojshme për arritjen e objektivave të tatimit në pronë - Inspektimi i objekteve për qëllim të tatimit në pronë dhe shërbimeve për rritjen, inkasim të llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë, siç përcakton ligji për tatimin në pronë që në komunë veprimtaritë inspektuese të kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat , sipas Përshkrimit të Shërbimeve / Artikujve dhe Çmimeve si dhe / ose Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : VU644-25-037-211 dhe që përfshin ekzekutimin e shërbimeve, me sa vijon:

- **Kryerja e shërbimeve inspektuese për verifikimin-anketimin e objekteve që janë në regjistrin e tatimit në pronë (fotografimi dhe vendosja e pikës);**
- **Kryerja e shërbimeve inspektuese për rexhistrimin e objekteve të reja për tatim në prone;**
- **Kryerja e shërbimeve Inspektuese për verifikimin të kulturës së destinimit të parcelave që tatimohen me tatimin në prone;**
- **Shërbimeve për inkasim dhe mbledhje të Tatimit në pronë - Përgaditja e letërkujtesave pët të gjithë tatimpaguesit që kan borgj mbi 99€ ndaj komunës dhe shpërndarja e tyre tek tatimpaguesit;**
- **Kryerja e shërbimeve për inkasim dhe mbledhje të detyrueshme e obligimeve të Tatimit në pronë - Përgaditja e marrëveshjeve për pagesën e borxhit të mbledhur ndërvite;**
- **Përgaditja dhe dizajnimi i broshurave me qëllim të ngritjes së vetëdijësimit të qytetarëve për pagesën e tatimit në pronë në qytet.**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej dhe / ose blej shërbime në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për shërbime dhe / ose furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Autoriteti Kontraktues dhe Menaxheri i Kontratës janë të obliguar të përdorin këtë marrëveshje kornizë kurdo që bënë blerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.

1.4 Sasitë e artikujve, si në pjesën II. Lista e Përshkrimit të Shërbimeve dhe Çmimeve, pjesë e kësaj Kontrate, nuk janë të parapara, dhe pragu plus/minus tridhjet përqind (30 %) nuk vlenë.

1.5 Njësia Kërkuese, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës i A.K. kanë përgjegjësinë e plotë që të kujdesen që sasitë e realizuara (shpenzuara) të shërbimeve të porositura të mos ndryshojnë substancialisht në raport me peshën e dhënë sipas grupeve të nëntotaleve si në Përshkrimin e shërbimeve si dhe çmimeve, që donë të thotë se nuk duhet të porositen vetëm shërbime nga një pozicion apo grup i shërbimit, por porosia duhet të jetë proporcioanle dhe në raport me peshën e dhënë si në Përshkrimin e shërbimeve , si dhe Çmimeve.

1.6 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari nga data: 13.10.2025 dhe përfundon më së largu deri më dt. 12.10.2027 duke përfshirë edhe këtë datë.

1.7 Nëse Urdhërblerja është dhënë pak kohë pra se kontrata publike kornizë të skadoj, dërgesa mundë të bëhet pas dates së skadimit të kontratës.

1.8 Nëse Urdhërblerjet arrijnë sasinë totale indikative të grupeve të përshkrimit të pozicioneve ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, pa marrë parasysh datën e saktësuar të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim të shërbimeve të porositur si dhe metodologjia e ekzekutimit, kontrollit dhe pranimit të shërbimeve do të saktësohet në Planin për Menaxhimin e Kontratës i cili duhet përpiluar pas nënshkrimit/ lidhjes të kontratës, nga palët kontraktuese repektivisht nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues dhe Menaxheri i Kontratës i Kryesit të Shërbimeve, SI DHE psi të jetë lëshuar – dërguar Porosia apo Thirrja nga ana e Autoritetit Kontraktues apo Organit tjetër të autorizuar.

2.2 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin ti ekzekutoi shërbimet e porositura dhe / ose *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha shërbimet* brenda afatit kohorë të specifikuar në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon pas skadimit të afatit të liferimit të shërbimeve sipas kësaj Kontrate dhe datës së dërgimit të Porosisë, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të porositura dhe / ose *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

2.3 Vendi i dorëzimit të ekzekutimit të shërbimeve, metodologjia e dorëzimit të shërbimeve si dhe Kontrolli i kualitetit te shërbimeve saktësohet nga personat përgjegjës te Autoritetit Kontraktues qe shfrytëzon kontratën. Kryesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose pengesave që mund të paraqiten, gjatë periudhës 24 mujore në kuptimin e funksionalitetit të sistemit (bazës së të dhënave), nënkupton që softverin ta mbajë aktiv dhe funksional.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve dhe / ose furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Shërbimeve dhe Çmimeve e dorëzuar nga Kryesi i Shërbimeve /Furnizuesi.

3.2 **Vlera totale e indikativë e Kontratës është: 150,000.00€ (njëqindepesdhjeteshtmij/00 Euro).**

3.3 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Kontigjentin e pranuar dhe të aprovuar nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

3.4 Shumat do të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

3.5 Kontraktuesi ka për obligim që shërbimet e porositura respektivisht shërbimet e ekzekutuara sipas përshkrimit teknik, të jenë cilësorë, me përshtatshmëri si dhe ti përmbushë në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoi Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës.

3.6 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar gjitha furnizimet ose shërbimet ose punët e porositura prej Menaxherit të Kontratës dhe të jenë pranuar nga Komisioni i Autoritetit Kontraktues për pranimin e mallit dhe / ose shërbimeve/punimeve të përfunduara.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(c) Oferta financiare ;
(d) Plani për menaxhimin e kontratës;
(e) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kurdo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[1] në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues Komuna e Vushtrrisë		Për Kontraktuesin : " M & IT L.L.C."– Ferizaj
Emri : Ilmi Azemi	**Emri : Ferit Idrizi**	**Emri : Arena Sylejmani**
Pozita : Drejtor i Prokurimit	Pozita : Kryetar i Komunës	Pozita : Drejtore Menaxhuese
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
Data: **13.10.2025**	Data: **13.10.2025**	Data: **13.10.2025**
V.V.	V.V.	V.V.

[1] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11.1	**Shërbimet e Ispektimi I objekteve per qellim te tatimit ne prone dhe sherbimeve per inkasimin te obligimeve te tatimit ne pronë ne komunën e Vushtrris .**
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është *menjëherë pas nënshkrimit te kontratës Autoriteti Kontraktues do ta caktoj menaxherin e kontratës.*
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është. **10% (Dhjetë përqind) e vlerës së përgjithëshme të kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.** **Dokumenti – Polisa e sigurimeve e lëshuar nga një kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës**
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: sipas KPK
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve: Kontrolli i kualitetit te shërbimeve behet nga personat përgjegjës te Autoritetit Kontraktues qe shfrytëzon kontratën. Ofruesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose pengesave mund të paraqiten, gjatë peridhes 24 mujore në kuptimin e funksionalitetit të sistemit (bazës së të dhënave). Pra ka për obligim që softverin ta mbajë aktiv dhe funksional.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, pjesë e Dosjes së Tenderit të këtij aktiviteti të prokurimit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Paramasa

Shërbime e nevojshme për arritjen e objektivave të tatimit në pronë - Inspektimi i objekteve për qëllim të tatimit në pronë dhe shërbimeve për inkasim të obligimeve të tatimit në pronë

Vërejtje: Çmimi për njësi të llogaritet me të gjitha taksat e aplikuara në Republikën e Kosovës

Pjesa A: pesha 35%					
Nr.	**Përshkrimi i shërbimeve**	**Njësia/matëse**	**Sasia**	**Çmimi për njësi**	**Totali**
1	Kryerja e shërbimeve inspektuese për verifikimin-anketimin e objekteve që janë në regjistrin e tatimit në pronë (fotografimi dhe vendosja e pikës).	Njësi të tatimore	1	15	15.00
2	Kryerja e shërbimeve inspektuese për rexhistrimin e objekteve të reja për tatim në pronë.	Rexhistrim	1	10	10.00
					-
				Totali Pjesa A	25.00

Pjesa B: pesha 20%					
3	Kryerja e shërbimeve Inspektuese për verifikimin të kulturës së destinimit të parcelave që tatimohen me tatimin në pronë	Parcelë	1	15	15.00
				Totali Pjesa B	15.00

Pjesa C :Pesha 25%					
4	Shërbimeve për inkasim dhe mbledhje të Tatimit në pronë - Përgaditja e letërkujtesave pët të gjithë tatimpaguesit që kan borgj mbi 99€ ndaj komunës dhe shpërndarja e tyre tek tatimpaguesit.	Copë	1	10	10.00

5	Kryerja e shërbimeve për inkasim dhe mbledhje të detyrueshme e obligimeve të Tatimit në pronë - Përgaditja e marrëveshjeve për pagesën e borxhit të mbledhur ndërvite.	Copë	1	3	3.00
				Totali Pjesa C	13.00

Pjesa D :Pesha 20%					
6	Përgaditja dhe dizajnimi i broshurave me qëllim të ngritjes së vetëdijësimit të qytetarëve për pagesën e tatimit në pronë në qytet	Copë	1	2	2.00
				Totali Pjesa D:	2.00

REKAPITULLIMI

		Çmimi për njësi i pa peshuar	Pesha	Çmimi për njësi i peshuar
1	Totali Pjesa A :	25	35%	8.75
2	Totali Pjesa B :	15	20%	3
3	Totali Pjesa C :	13.00	25%	3.25
4	Totali Pjesa D :	2	20%	0.4
Totali		55	100%	15.4

	Tabela e kalkulimit te çmimit për Kontrat Publike Kornizë - Pune - Çmimi për njësi i peshuar (poentuar),sipas kategorive ku vlera e parashikuar e kontratës është 150,000.00 Euro					
	LISTA E CMIMEVE - PARAMASA DHE PARALLOGARI PUNE-PROJEKTE TE VOGLA NE INFRASTRUKTURE					
	Përshkrimi I shërbimeve				**Çmimi total35% e pikeve per vlersim**	**Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë A**
A/1	**PUNET PERGADITORE**	**Njesia**	**Sasia**	**Çmimi njesi me TVSH (€)**		
	Verejteje: Operatori Ekonomik eshte i obliguar qe shërbimet ti kryej ne perputhshmeri te plote me Nenin 1, nenparagrafet 1.4, 1.5 dhe 1.6 te Kontrates se dhënë.					
1.1	Kryerja e shërbimeve inspektuese për verifikimin-anketimin e objekteve që janë në regjistrin e tatimit në pronë (fotografimi dhe vendosja e pikës).	njësia tatimore	**1**	**15.00 €**		
1.2	Kryerja e shërbimeve inspektuese për rexhistrimin e objekteve të reja për tatim në pronë	njësia tatimore	**1**	**10.00 €**	**35%**	
	Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total te peshuar, Kategoria A (1.1-1.2)			**25.00 €**	**52,000.00 €**	**52,500.00 €**
B/2	**Përshkrimi I shërbimeve**	**Njesia**	**Sasia**	**Çmimi njesi me TVSH (€)**	**Çmimi total 20% e pikeve per vlersim**	**Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë B**
2.1	Kryerja e shërbimeve Inspektuese për verifikimin të kulturës së destinimit të parcelave që tatimohen me tatimin në pronë	parcelë	1	15.00 €	**20%**	
	Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total te peshuar (2.1)			**15.00 €**	**30.000.00**	**30,000.00 €**
C/3	**Përshkrimi I shërbimeve**	**Njesia**	**Sasia**	**Çmimi njesi me TVSH (€)**	**Çmimi total 25% e pikeve per vlersim**	**Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë C**
1	Shërbimeve për inkasim dhe mbledhje të Tatimit në pronë - Përgaditja e letërkujtesave pët të gjithë tatimpaguesit që kan borgj mbi 99€ ndaj komunës dhe shpërndarja e tyre tek tatimpaguesit	copë	1	10.00 €	**25%**	
2	Kryerja e shërbimeve për inkasim dhe mbledhje të detyrueshme e obligimeve të Tatimit në pronë - Përgaditja e marrëveshjeve për pagesën e borxhit të mbledhur ndërvite.	copë	1	3.00 €		
	Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total te peshuar, Kategoria C (3.1-3.2)			13.00 €	37,500.00 €	**37,500.00 €**
D/4	**Përshkrimi I shërbimeve**			**Çmimi njesi me TVSH (€)**	**Çmimi total 20% e pikeve per vlersim**	**Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë D**
1	Përgaditja dhe dizajnimi i broshurave me qëllim të ngritjes së vetëdijësimit të qytetarëve për pagesën e tatimit në pronë në qytett	copë	1	2.00 €	**20%**	
	Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total te peshuar, Kategoria D (4.1)			2.00 €	30,000.00 €	**30,000.00 €**

	Për Autoritetin Kontraktues- Komuna Vushtrri		**Për Kryesin e Shërbimeve: " M&IT L.L.C. "**
	Ilmi Azemi		**Arena Sylejmani**
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	***13.10.2026***	***Data:***	**13.10.2026**
Vula:		***Vula:***	